



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.632/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet Erxhan Galushi nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit dhe Komunën e Obiliqit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

HUDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.632/2025 e parashtruar nga kandidati për deputet Erxhan Galushi nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren , paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit dhe Komunën e Obiliqit , për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.632/2025 të parashtruar nga kandidati për deputet Erxhan Galushi nga subjekti politik Partia e Bashkuar Rome e Kosovës (PREBK) në të cilën pretendohet se dyshohet që kandidati Erxhan Galushi ka marrë më pak vota nga ato që është dashur të marrë, duke u bazuar në numrin e vogël të votave që ai ka marrë në shkollën "Motrat Qirijazi" në Prizren, ku shumica e votuesve kanë qenë familjarë të deputetit Galushi. Ky fakt ka ngritur dyshime për mundësinë e gabimeve gjatë procesit të numërimit të votave, të cilat mund të kenë ndodhur për shkak të ndikimeve të jashtme, në favor të kandidatit Albert Kinolli.

Për më tepër, besoj se mund të ketë pasur gabime të ngjashme edhe në shkolla të tjera në Komunën e Prizrenit dhe në Komunën e Obiliqit. Ky shqetësim kërkon shqyrtim të mëtejshëm për të siguruar që procesi zgjedhor ka qenë i drejtë dhe transparent, pa pasur ndikime të jashtme. Në ankesë parashtruesi kërkon që PZAP të shqyrtojë mundësinë e gabimeve në numërimin e votave dhe të urdhërojë rinumërimin e votave për kandidatët e subjektit politik (PREBK), me theks të veçantë në shkollën "Motrat Qirijazi" dhe shkolla të tjera, brenda qytetit të Komunës së Prizrenit, ku ka dyshime për mundësinë e ndikimeve të jashtme.

Parashturesi i ankesës po ashtu ka theksuar se kërkon gjithashtu që të shqyrtohen mundësitë e gabimeve të ngjashme në Komunën e Obiliqit dhe të verifikohet procesi i numërimit të votave për të siguruar që çdo votë është numëruar saktë dhe pa pasur ndikime të jashtme. Ky rinumërim është i nevojshëm për të siguruar që procesi zgjedhor ka qenë i drejtë dhe pa ndikime të jashtme.

Ne përgjigje në ankesë nga KQZ theksohet se ankesa lidhur me pretendimet e palës ankuese për rinumërimin dhe shqyrtimin e mundësisë së gabimeve në numërimin e votave për kandidatin në Komunën e Prizrenit është e pasafatëshme, sepse me datën 19.02.2025 në ora 17:20 është përmbyllur procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime më 9 shkurt 2025, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit dhe me datën 14 shkurt në Komunën e Obiliqit dhe i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë dorëzuar nga Komisionet Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) të këtyre dy komunave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Pretendimet janë të përgjithshme, të mbështetura pa asnjë provë, jo të konkretizuara, të pa specifikuar se sa vota i mungojnë, në cilat shkolla i mungojnë votat e familjarëve të cilët thekson se kanë votuar për të, në cilat vendvotime ka pasur gabime gjatë numërimit të votave të kandidatëve nga ekipet e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prizren dhe në Obiliq. Gjithashtu pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota nuk nënkupton se ka pasur gabime në numërimin e votave në QKN. Pavarësisht se ankesa e ankuesit është e pas aftëshme dhe e pa bazuar, lidhur me pretendimet e palës ankuese edhe pse i referohet mundësinë e gabimeve në numërimin e votave në QKN, ku si rezultat i këtyre gabimeve gjoja se ankuesi është dëmtuar me vota, nuk qëndrojnë sepse nuk janë shpallje e rezultateve përfundimtare, por rezultatet në QKN kanë qenë forma të rezultateve të plotësuara në Qendrat Komunale të Numërimit nga ekipet e numërimit dhe të gjithë të interesuarit kanë mundur t'i shohin rezultatet e çdo vendvotimi duke shfletuar kopjet e formularëve me qëllim të rritjes së transparencës për procesin zgjedhor.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se :

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ankesa është dorëzuar me datën 06.03.2025, kurse nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-i dhe nga përgjigja e KQZ-së, procesi i numërimit në QKN Prizren është përfunduar më datën 19.02.2025 në ora 17:20, ndërsa procesi i numërimit në QKN Obiliq ka përfunduar me datë 14.02.2025 që do të thotë se ankesa për të dy komunat është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik PREBK Erxhan Galushi, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se e njëjta është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 632/2025 më datën 07.03.2025



Këshilla Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*